

BULETIN INFORMATIV

Janar - Qershor 2009

**KOMISIONI PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE
MIRËQENIE SOCIALE**



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Qershor 2009



Fushëveprimtaria e Komisionit

PËRMBAJTJA

FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2009

MBLEDHJET E KOMISIONIT

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE

DËGJIMET PUBLIKE

MBIKËQYRJA E LIGJEVE

RAPORTIMI I MINISTRAVE DHE
PËRFAQËSUESVE TJERË

VIZITAT

STATISTIKA

PËRBËRJA E KOMISIONIT

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është njëri nga komisionet funksionale në Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili ka të përcaktuara kornizat e fushave brenda të cilave zhvillon veprimtarinë e tij. Në kuadër të fushëveprimit të tij, Komisioni angazhohet në:

- përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave për zhvillimin dhe funksionimin sa më efikas të shëndetësisë dhe çështjeve sociale në Kosovë, të cilat ushtrohen nga Institucionet e Republikës së Kosovës;
- krijimin e një ambienti ligjor të përshtatshëm për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale të qytetarëve të Kosovës, duke nxitur aplikimin e standardeve bashkëkohore;
- konceptimin e një strategjie të përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore dhe sociale të qytetarëve të Kosovës;
- mbikëqyrjen e punës së Qeverisë në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale;
- integrimin e institucioneve shëndetësore në asociacionet ndërkombëtare të shëndetësisë;



Plani i Punës për vitin 2009

Në përputhje me Strategjinë Legjislative të Qeverisë dhe objektivat, në muajin shkurt, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka hartuar dhe miratuar Planin e Punës për vitin 2009, në bazë të të cilit këtë gjashtëmujor ka zhvilluar aktivitetet si komision funksional.

Plani i Punës për vitin 2009 ka paraparë: shqyrtimin e të gjitha projektligjeve që i përkasin fushave që mbulon Komisioni, zhvillimin e vizitave nëpër institucionet shëndetësore dhe sociale, realizimin e ndonjë vizite studimore jashtë vendit, monitorimin e zbatimit të ligjeve të përzgjedhura nga Komisioni, organizimin e dëgjimeve publike për ligje të caktuara, raportimin e ministrave përkatës dhe përfaqësuesve tjerë para Komisionit për çështjet që Komisioni i vlerëson të rëndësishme, bashkëpunim me të gjitha organizatat relevante vendore e ndërkombëtare dhe ka paraparë të bashkëpunoj ngushtë me ministritë përkatëse në hartimin e buxhetit për vitin 2010.



Mbledhjet e Komisionit

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në gjashtëmujorin e parë, ka mbajtur *18 mbledhje të rregullta*. Në këto mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar disa projektligje për të cilat është caktuar si komision funksional. Për këto projektligje, Komisioni ka përgatitur raporte me amendamente, të

Cilat i janë rekomanduar komisioneve kryesore për shqyrtim dhe miratim. Komisioni ka shqyrtuar edhe një numër të kërkesave drejtuar atij nga institucione të ndryshme për çështje të caktuara. Gjithashtu, Komisioni ka zhvilluar disa debate për çështjet që ka konsideruar që janë me rëndësi.

Në këtë gjashtëmujor, Komisioni ka formuar *3 grupe punuese*, një grup punues për Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj, një grup punues për Letrën e Bardhë për Sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë dhe një grup punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës. Puna profesionale e grupeve punuese është më efikase, dhe kjo ka ndikuar që Komisioni të jetë më funksional dhe ka paraqitur rezultate të mira.

Me ftesë të Komisionit, në mbledhje kanë prezantuar Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe përfaqësues të tjerë nga këto dy ministri. Gjithashtu, para Komisionit kanë prezantuar edhe përfaqësues të institucioneve shëndetësore publike dhe përfaqësues të tjerë.



Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë përcjell nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare vendore e ndërkombëtare. Në mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar debate të hapura dhe konstruktive. Vendimet e Komisionit në shumicën e rasteve kanë qenë konsesuale. Në përgjithësi, në çdo aspekt, mbledhjet e Komisionit kanë qenë të suksesshme dhe kanë plotësuar standardet demokratike.

Shqyrtimi i Projektligjeve

Në gjashtëmujorin e parë, Komisioni për SHPMS, ka shqyrtuar 3 projektligje. Projektligjet e shqyrtuara janë:

- Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmave sociale;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin;



Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj është amendamentuar nga Komisioni dhe është proceduar për shqyrtim në Kuvend. Ndërsa, Projektligji për skemën sociale është shqyrtuar në Komision dhe pas vlerësimit të kostos buxhetore për implementimin e tij është tërhequr nga Qeveria për një kohë të pacaktuar. Projektligji për duhanin është shqyrtuar

në parim nga Komisioni dhe është proceduar për leximin e parë në Kuvend.

Në këtë gjashtëmujor, Komisioni ka shqyrtuar edhe tri çështje me rëndësi për fushat të cilat i mbulon, si: *Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2010-2012 dhe Letrën e Bardhë për Sfidat e Përfshirjes Sociale në Kosovë, si pjesë e dalë nga Deklarata e Mijëvjeçarit e miratuar nga Kuvendi.*

Në muajin Janar, Komisioni ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2008. Gjithashtu, në këtë gjashtëmujor, Komisioni, ka shqyrtuar 6 kërkesa, pas shqyrtimit të të cilave ka dhënë rekomandimet e tij.



Dëgjimet Publike

Me qëllim të grumbullimit të sa më shumë informatave dhe përfaqësimit sa më të madh, duke përfshirë edhe grupet e interesit, Komisioni organizon dëgjime publike. Është me interes që në këto takime të përfshihen sa më shumë përfaqësues të grupeve që preken drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë nga ligji apo çështja për të cilën debatohet.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në muajin shkurt, ka mbajtur një dëgjim publik për monitorimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi. Qëllimi i dëgjimit ka qenë mbledhja e sa më shumë informatave për Komisionin në zbatimin e ligjit. Në dëgjim kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, përfaqësues të institucioneve shëndetësore publike dhe private, përfaqësues të asociacioneve shëndetësore dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbikëqyrja e Ligjeve

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, neni 53, Komisioni ka autoritetin të mbikëqyr zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose ministria përkatëse. Mbikëqyrja e ligjeve nga Komisioni bëhet me qëllim të vlerësimit të zbatimit të ligjeve dhe ndërmarrjes së masave për përmirësimin e gjendjes së zbatueshmërisë duke propozuar rekomandime konkrete për institucionet përgjegjëse.

Në bazë të këtij autoriteti, në vitin 2008, Komisioni kishte përzgjedhur të monitoroj zbatimin e *Ligjit për Veprimtarinë Private në Shëndetësi*, i cili për këtë qëllim kishte formuar një grup punues. Komisioni, i mbështetur nga stafi mbështetës dhe NDI, kishte zhvilluar të gjitha aktivitetet e nevojshme për të parë nivelin e zbatimit të ligjit në fjalë. Aktivitetet për monitorimin e këtij Ligji kanë vazhduar edhe



këtë vit. Në shkurt të 2009, Komisioni ka mbajtur një dëgjim publik për monitorimin e Ligjit për Veprimtarinë Private në Shëndetësi. Pas dëgjimit, grupi punues ka hartuar raportin të cilin e ka shqyrtuar dhe miratuar Komisioni. Raporti me rekomandime është miratuar në Kuvend me rekomandimin që në afatin sa më të shpejt Ministria e Shëndetësisë t'i zbatoj rekomandimet e raportit.

Në muajin Qershor, Komisioni ka vendosur, që për vitin 2009, të monitoroj Ligjin për Inspektoratin e Punës. Për këtë qëllim, Komisioni, ka formuar një grup punues, i cili pas realizimit të aktiviteteve të nevojshme do të përgatisë një raport me rekomandime. Mbështetje në monitorimin e zbatimit të këtij ligji do të ofroj edhe NDI.



Raportimi i Ministrave dhe përfaqësuesve tjerë

Në gjashtëmujorin e parë, me kërkesë të Komisionit, kanë raportuar Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Nenad Rashiq, dy herë, dhe Ministri i Shëndetësisë, z. Alush Gashi. Ministri Rashiq ka raportuar për gjendjen sociale në Kosovë, e në mënyrë të veçantë për problemet me skemën sociale, punësimin, pensionet, vonesën në procedimin e Projektligjit të Punës, etj. Ndërsa, herën e dytë, ka raportuar për planin e veprimit të Kuvendit për sfidat e raportit të progresit për vitin 2008. Ndërkaq, Ministri i Shëndetësisë z. Alush Gashi, ka raportuar për gjendjen e shëndetësisë në Kosovë, e me theks të veçantë për furnizimin me barëra të QKUK-së, nivelin e zbatimit të Ligjit për veprimtarinë private në Shëndetësi, vonesën e procedimit të Projektligjit për sigurimet shëndetësore, etj.

Gjithashtu, me ftesë të Komisionit, kanë prezantuar përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Vizitat

Në kuadër të fushëveprimit të tij dhe funksionit të mbikëqyrjes së punës së institucioneve në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale, Komisioni për SHPMS në gjashtëmujorin e parë, ka zhvilluar dy vizita në terren. Komisioni ka bërë një vizitë në Institutin e Kosovës për Shëndetësi Publik. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi me masat e marra dhe përgatitjet e bëra nga instituti për “gripin e derrave”. Vizitën e dytë, Komisioni, e ka realizuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Qëllimi i kësaj vizite ishte gjendja aktuale në furnizimin me barëra dhe nevojat tjera të kësaj qendre.

Statistika

- Mbledhje të komisionit	18
- Projektligje të shqyrtuara	3
- Grupe punuese të formuara	3
- Takime të grupeve punuese	6
- Monitorimi i ligjeve	1
- Vizita në terren	2
- Raportimi i ministrave	3
- Dëgjime publike	1


Përbërja e Komisionit



Sadik Idriz (7+)
Kryetar i Komisionit




Rita Hajzeraj (AKR)
Zëvendëskryetare e Parë



Slobodan Petrovic (SLS)
Zëvendëskryetar i Dytë



Teuta Hadri (PDK)
Anëtare



Flora Brovina (PDK)
Anëtare



Nurishahe Hulaj (LDK)
Anëtare



Bujar Bukoshi (LDK)
Anëtar



Armend Zemaj (LDK)
Anëtar



Gjylnaze Sylaj (AAK)
Anëtare



Qamile Morina (LDD)
Anëtare



Mimoza Ahmetaj (PDK)
Anëtare



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati përdhes

038 211 186
sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Shpresa Haxhijaj Administratore e Zyrës

038 211 294
shpresa.ramosaj@assembly-kosova.org

Drita Morina Zyrtare e Lartë Ligjore

038 211 293
drita.morina@assembly-kosova.org

Fatime Qorri Zyrtare Ligjore

038 213 803
fatime.qorri@assembly-kosova.org

Mirjeta Heta Nëpunëse Administrative

038 211 302
mirjeta.heta@assembly-kosova.org

Zyrtari nga NDI që mbështet Komisionin

Shefki Kastrati Zyrtar Legjislativ

Zyra N - 409, Kati IV

038 212 532 shefkikastrati@gmail.com
044 513 651

Webfaqja e Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

